

**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SARANDË SH.A**

Sarandë më 15.05.2024

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**«Mirembajtja dhe riparimi i elektropompave te stacioneve te pompimit te Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sh.A.».**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Sherbime per riparimin dhe mirembajtjen e pompave, CPV 50511000-0**

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**12 656 525(dymbëdhjetëmilion gjashtëqind pesëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH.**

**Shumatorja e çmimeve për njësi është : 12 656 525(dymbëdhjetëmilion gjashtëqind pesëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sarande Sh.a ,ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 2(dy) viteve të fundit ushtrimore (2022 dhe 2023) lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa 30% të vlerës së përlllogaritur të kontratës.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilanceve, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) për vitet 2022 dhe 2023 ku të paktën në dy bilancet e njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar

### 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë sa 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

#### 2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme

NP.7. ”Ujesjelles, gazsjelles, vajsjelles, vepra kullimi e vaditje”, të lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Urban.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe ne.

Ligjin nr. 8402, date 10.9.1998 “per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” ndryshuar me:  
• ligjin nr. 9200, date 26.2.2004 • ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007 • ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007 • ligjin nr. 10 137, datë 11.5.2009 • ligjin nr. 10 324, datë 23.9.2010 • ligjin nr. 11/2012, datë 09.02.2012

VKM nr.42, datë 16.1.2008 për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

*“Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.*

*Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.”*

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

Inxhinier Mekanik 1 (nje)

Inxhinier Elektrik 1 (nje)

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës **të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

1. Elektracist 1 (nje)

2. Mekanik 1 (nje)

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës **të paspecializuar**, si më poshtë

1. Punetor 2(dy)

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

Vertetim nga Administrata Tatimore për numrin e të siguruarve mujor,

kontrata individuale të punësimit, diplome (për inxhinieret), certificate të sigurimit teknik për inxhinieret dhe specialistet, (leshuar nga IQT ose institucion tjetër i licensuar) dhe të figurojnë në listpagesat e muajve Janar – Mars 2024.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b,c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

*Ne gjykojmë se, për të kryer këtë proces pune, sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të paracaktuara, operatori ekonomik, duhet të ketë të punësuar të pakten 6 (gjashtë) persona. Inxhinierin Mekanik dhe Mekanikun për të vlersuar dhe kryer punimet mekanike, Inxhinierin Elektrik dhe Elektracistin, për të vlersuar dhe kryer punimet elektrike, dhe dy punetore jo domosdoshmerisht të kualifikuar, për të kryer kryesisht punet me natyrë fizike.*

*Gjithashtu, punonjësit e kualifikuar, duhet të jenë të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, sepse, do të duhet që të punojnë në pajisje mekanike rrotulluese dhe nën ngarkesë të rrymës elektrike, kështu që duhet të jenë të aftë, të mbrojnë veten dhe kolegun nga aksidentet në punë.*

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

*Autovinc per nxjerrjen e pompave nga puset, me peshe ngritese minimalisht 2.5 ton*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

*Ky lloj mjeti eshte i domosdoshem per te nxjerre dhe rifitur pompen ne pus, duke patur parasysh se pesha maksimale e pompes qe mund te defektohet dhe te nxirret, motorit, tubacionit dhe kollones se ujit shkon afersisht 2.2 ton.*

## **2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

**2.4.1** Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me certifikatat ISO të vlefshme, si me poshte

**Certifikate EN-ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit te cilesise/ ose ekuivalent**

**Certifikate ISO 45001:2018 Sistemi i menaxhimit dhe sigurise ne pune / ose ekuivalent**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 2,c, të nenit të 79, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që:


*Te jene te pajisur me certifikate te sistemit te menaxhimit te cilesise per aresye se punimet per mirembajtjen dhe riparimin e ketyre elektropompave , per vete rendesine qe ato kane, si aggregate, qe sherbejne per furnizimin me uje te popullates dhe per largimin e ujrave te ndotur, duhet te jene te nje cilesie te larte per te zgjatur periudhen e funksionimit te pavarur deri ne riparimin tjeter.*

*Te jene te pajisur me certifikate te sistemit te menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune, meqenese ne kete natyre pune, rrezikshmeria eshte me e larte, per aresye se kemi te bejme me punime ne pajisje te rrymes elektrike, dhe duke qene se, specialistet e ketij operatori do te punojne ne mjediset tona, se bashku me specialistet tane, ai duhet te jete i afte te mbroje jeten edhe te punonjesve tane.*

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

### 1. Informacion mbi stacionet e pompimit dhe vendndodhjen e tyre.

Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sh.A. Sarande, administron sherbimet e furnizimit me uje te pijshem dhe largimin e ujrave te ndotur ne njesite bashkiake Sarande, Delvine, Finiq dhe Konispol dhe per rrjedhim edhe stacionet e pompimit qe nevojiten per kryerjen e ketij sherbimi. Zona e rrethuar ne figuren e meposhtme eshte zona e sherbimit te shoqerise




Me konkretisht;

Njesia Sarande ka keto stacione pompimi


Vrion, Shelegar, Cuke (Radiostacioni), Cuke (Fshat), Manastir, 26 Marsi, Pema e thate (Ksamil), Spital, Rruga Ura, Baba Rexhep, Lugu I Dardhes, Lekures, Gjashte, (Sarande) si stacione te ujit te pijshem dhe S.P.U.N Sarande dhe stacionet nr 1.2.4.5.6 ne Ksamil si stacione te largimit te ujrave te ndotura.





Njesia Delvine ka keto stacione pompimi

Vriz dhe Ish.Reparti Ushtarak ne Delvine dhe ne fshatrat Fushe Veri,Vergo,Kopaces,Palavli,Vllahat,Stjar,Rusan



Njesia Konispol ka keto stacione pompimi


Konsipol, Ciflig,Shkalle,Mursi,Markat,Merko,Verve,Dishat,Janjar,Shales



Njesia Finiq ka keto stacione pompimi

Bregas,Vrion,Dermish,Muzine,Dhrovjan,Pece,Krongj,Livine,Karahaxh dhe Kostar





Duhet theksuar se stacionet e njesive te tjera bashkiake, pervec Sarandes, jane stacione pompimi te ujit te pijshem,

## ***2.Kategorite e punimeve***

Punimet qe do te kryhen,per mirembajtjen dhe riparimin e elektropompave,jane dy llojesh;

*Punime mekanike qe perfshijne riparimin dhe mirembajtjen e pompave.*

Me konkretisht, ne keto punime perfshihen;

zmontimi i pompes nga bazamenti ose nxjerrje nga pusi,transport ne piken e servisit, demontim i vete pompes, riparim ose zevendesim i pjeses se demtuar( kushinete, bosht, permistop, bokoll, distancator, difuzor, elike, etj), montim i pompes, risjelleje ne stacion dhe motim ne bazament ose ne pus.

Pervec ketyre, perfshihen edhe disa punime te tjera te mirembajtjes prventivuese, si grasatime kushinetash ose lubrifikim me vaj, sipas rastit,vendosje litari amianti, shtrengime bulonash, etj.

*Punime elektrike, qe perfshijne riparimin dhe mirembajtjen e elektromotoreve.*

Edhe per punimet elektrike, do te ndiqet i njejti proces pune si per pompat,por per elektromotoret, eshte parashikuar kryesisht avolzhimi(ripeshtjellimi) i tyre dhe, ne disa raste, edhe zevendesimi i pjeseve te tjera te kembimit, si kushineta,permistopa,boshte etj.

### ***3.Preventivi dhe te dhena te tjera teknike***

Ne preventivin hartuar per realizimin e kesaj procedure prokurimi percaktohen; marka dhe tipi i pompes dhe i elektromotorit,numrat e pompave dhe elektromotoreve.

Ne preventiv jane te perfshira edhe punimet shtese si,demontim dhe montim i pajisjes(nxjerrje dhe rifutje ne pus),transport deri ne piken e servisit dhe risjellje,per cdo sherbim qe do te kryhet dhe do t'i kete te nevojshme keto punime.

Ne preventiv jane paraqitur punimet dhe pjeset e kembimit, qe mund te nevojiten per nje elektropompe ,te cdo marke ose te cdo stacioni pompimi, por, Autoriteti Kontraktor, ka te drejte, qe te riparoje me shume se nje pompe te se njejtës marke,mjafon qe ky punim te kryhet ne baze se vlerse se ofertuar per riparimin e kesaj pompe dhe vlera totale e punimeve ne asnje rast te mos e kaloje vleren totale te kontrates.

Pjeset e kembimit qe do te perdoren per riparimin e pompave dhe elektromotoreve, do te perferohen te jen nga prodhuesi i vete pajisjes por do te pranohen edhe ato ekuivalente.

Lubrifikantet qe do te perdoren per pompat zhytese te largimit te ujrave te ndotura do te jene vajra jo toksike tip Mercury No;7174,Merkur White oil Pharma 40 ose ekuivalent SAE 10W, SAE 20W dhe graso ESSO UNIRES N3, FAG ARCANOL L40,TEXACO HYTEC EP3/DEA Pragon ose ekuivalente me to.Sasia e lubrifikanteve dhe ftohesve, pasqyrohet ne preventiv,prandaj njesia e ketij zeri punimi pershkruhet “ls”, qe do te thote se ne te prmbliidhet gjithë sasia e lubrifikantit dhe puna qe do te behet per t'a nderruar ate.

### ***4.Sqarime dhe detyrime per operatorin ekonomik***

Operatori ekonomik ose ofertuesi,kur te paraqese oferten e tij,duhet te kete parasysh se, cdo ze punimesh ,qe do te kryhet,ne rastet kur do te kerkoje zevendesim te pjeseve te demtuara,eshte furnizim dhe vendosje e kesaj pjese,prandaj zeri i ***punetorise(hak pune)***,nuk do te paraqitet me vete ne preventiv.

Nga ana tjeter, operatoret ekonomike, qe do te marrin pjese ne konkurim, duhet t'a kene te qarte se,meqenese kemi te bejme me nje procedure konkurimi, qe do t'i paraprijë nje ***marreveshjeje kuader***,Autoriteti Kontraktor nuk eshte i detyruar te kryeje cdo punim sipas zerave te preventivit,dhe te paguaje te gjithë vleren limit te kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontraktor do te paguaje operatorin ekonomik, per ato pune,sherbime,riparime, qe do te ndodhin faktikisht.

Operatori ekonomik,eshte i detyruar te kryeje me cilesi te larte dhe ne kohe, cdo punim, qe do t'i kerkoje autoriteti kontraktor,sipas zerave te punimeve ne preventiv,brenda vleres limit per cdo ze(njesi),qe operatori ekonomik, ka ofertuar.

Per cdo punim(riparim) te kryer, operatori ekonomik duhet te leshoje nje certificate garancie, me afat jo me te vogel se nje vit, nga data e dorezimit perfundimtar te sherbimit. Cdo defekt qe do te ndodhe ne pajisjen e riparuar, brenda periudhes se garancise, do te riparohet nga operatori ekonomik(me vone kontraktuesi), me shpenzimet e tij.

Operatori ekonomik, duhet te marre masa qe, cdo pjese kembimi, te percaktuar ne preventiv, ne baze te markes,tipit,apo numrit te pajisjes, te jete ne gjendje t'a siguroje dhe sa me shpejt.Mospasja apo mossigurimi ne kohe i kesaj apo ketyre pjeseve te kembimit, ne qofte se do te sjelle vonesa te pajustificueshme per riparimin e agregatit dhe si rrjedhim edhe te punes normale te stacionit te pompimit, do te behet shkak per zgjidhjen e njeanshme te kontrates.

### ***5.Praktika e punimeve***

Operatori ekonomik(kontraktuesi) , do te njoftohet zyrtarisht(bejne perjashtim rastet, qe do te konsiderohen emergjente nga Autoriteti Kontraktor) per defektin dhe pa humbur kohe do te paraqitet me specialistet e tij prane stacionit qe do te kete problem.Pas konstatimit, konfirmimit te defektit, nga te dyja palet, pra specialistet e tij dhe tanet, agregati i demtuar do t'i dorezohet operatorit, me ane te nje akti dorezimi ose flete daljeje provizore.

Operatori ekonomik(me vone kontraktuesi), pasi t'a verifikojte me ne thellesi defektin, duke e zmontuar agregatin ne piken e tij te servisit,do t'i dergoje Autoritetit Kontraktor, nje raport te hollesishem teknik, ku te pershkruhen ne menyre te detajuar defektet e ndodhura dhe sipas tij, aresyen perse kane ndodhur dhe se bashku me te nje preventive-oferte, per punimet dhe pjeset e kembimit te nevojshme per riparim, duke iu permbajtur rigorozisht, kushteve te parashkuara ne kontrate.

Pasi Autoriteti Kontraktor, t'a kete miratuar kete sherbim, operatori do te vazhdoje pune, per riparimin e defektit, sipas afateve te paracaktuara.Pas perfundimit te riparimit,operatori do te kryeje testimet e nevojshme, te cilet , do t'ia paraqese edhe Autoritetit Kontraktor dhe do t'a montoje pajisjen ne stacion.Agregati ose pajisja do te punoje ne periudhe prove per 72 ore, dhe pas kesaj, do te merret ne dorezim, me nje garanci, te pakten nje vjecare.

Per te gjitha keto hapa, qe pershkruam me lart, autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik(kontraktuesi) do te plotesojne nje dokumentacion,i cili do te pershkruhet me hollesisht ne kontrate.

*Ne rastet qe, do te konsiderohen emergjente nga Autoriteti Kontraktor,prioritet do t'i jepet zgjidhjes sa me shpejt te problemit, perkunder dokumentimit rigoroz te proceseve qe pershkruam me siper.Por, sidoqofte,edhe ne keto raste, per aq sa eshte e mundur, do te mbahet nje dokumentacion, i cili te deshmoje punen e kryer.*

### ***6.Afati i punimeve***

Afati i kesaj marreveshjeje , do te jete ***nje vjecar***,pra, per nje vit, nga data e lidhjes se kontrates, operatori ekonomik fitues, do te jete pergjegjes per mirembajtjen e pajisjes elektromotor pompe, sipas kushteve te parashkuara ne preventiv dhe specifikime teknike.Ndersa afati ikontratave qe do te lidhen, bazuar ne kete marreveshje, do te vendoset ne varesi te punimeve te nevojshme,per riparimin e defektit(eve) per cdo rast, ne

varesi te rendesise teknologjike qe ka ky stacion pompimi,pompa e te cilit eshte defektuar, apo edhe ne varesi te periudhes kohore ne te cilin ndodh defekti(perben emergjence apo jo).

**Argumentimi;** *Specifikimet teknike jane hartuar bazuar ne nenin 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”*

*Duke qene se kjo procedure,eshte nje kontrate sherbimesh, riparimesh, mirembajtjeje, te pajisjeve ekzistuese, pra motore dhe pompa, qe jane tashme te instaluar, per te percaktuar sherbimet ne to, pra zevendesimet e pjeseve te kembimit, jemi te detyruar t’i referohemi, markave te produketeve te tyre ,per produkte qe prodhohen ne menyre ekskluzive, vetem nga prodhuesi i agregatit te caktuar.Por sigurisht, qe do te pranohen edhe pjese kembimi te njejta nga pikepamja e karakteristikave teknike, por nga prodhues te ndryshem, pra ekuivalente, per produkte qe prodhohen edhe nga prodhues te tjere, psh, per kushinetat. Karkateristikat teknike te pompave jepen ne preventivin qe shoqeron kete procedure.*

*Ne specifikimet teknike, pershkruhen me hollesi edhe lubrifikantet qe, do te perdoren per keto makineri dhe pajisje, per perdorimin kryesisht te vajrave jo toksike,por edhe ne kete rast, pershkrimi eshte shoqeruar me fjalen “ekuivalente”*

#### NJESIA E PROKURIMIT

ANILA VJERI

LAERT ILJAZI

SOVJET HABUPI